

VENDIM
Nr.278, datë 29.10.2004

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “DEVI”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “DEVI-E.R.I.” sh.p.k.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll” të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe I Televisionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Devi-E.R.I.” sh.p.k., licencë, duke autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televisionit me kabëll, për të penetruar në qytetin e Gramshit, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR
Albert Minga